



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr.213 Akti

Nr.126 Vendimi

Tiranë, më 22.11.2019

**V E N D I M**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Brunilda Bektoshi	Kryesuese
Xhensila Pine	Relatore
Suela Zhegu	Anëtare

në prezencë edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Hans Kiljstra, asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Etmonda Hoxha, në datat 15 nëntor 2019, ora 10:00 dhe 21 nëntor 2019, ora 10:00, në Pallatin e Koncerteve, (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0, (underground), Tiranë, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike çështjen që i përket:

**SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT:** Z. Simon Pashuku, prokuror pranë Prokurorisë së Shkallës së Parë Lezhë.

**OBJEKTI:** Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.

**BAZA LIGJORE:** Neni 179/b i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe neni A, Ç, D, Ë të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

**KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT,**

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, mori në shqyrtim dhe analizoi provat shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit kryesisht, dëgjoi subjektin e rivlerësimit, z. Simon Pashuku, si dhe bisedoi çështjen në tërësi,

**V Ë R E N:**

1. Z. Simon Pashuku është subjekt i rivlerësimit për shkak të funksionit të tij si prokuror pranë Prokurorisë së Shkallës së Parë Lezhë, bazuar në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

2. Z. Simon Pashuku i është nënshtruar procesit të rivlerësimit, duke u shortuar në datën 15.3.2018, bazuar në pikën 2, të nenit 14, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, nga ku rezultoi se shqyrtimi i çështjes do të bëhet nga trupi gjykues nr. 3, i përbërë nga komisionerët Brunilda Bekteshi, Xhensila Pine dhe Suela Zhegu.

3. Trupi gjykues, me vendimin nr. 1, datë 21.3.2018: caktoi me mirëkuptim kryesuese komisioneren Brunilda Bekteshi; u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e trupit gjykues; si dhe u vendos fillimi i hetimit administrativ, me qëllim kryerjen e procedurave të rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit.

4. Në bazë të pikës 1, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, për subjektin e rivlerësimit, z. Simon Pashuku, nisi procesi i rivlerësimit dhe hetimi i thelluar administrativ

5. Menjëherë u administruan nga relatori raportet e vlerësimit të hartuara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI), sipas neneve 31 - 33 të ligjit nr. 84/2016; nga Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim DSIK), sipas neneve 34 - 39, të ligjit nr. 84/2016; dhe nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë (në vijim KLP), sipas nenit 44 ligjit nr. 84/2016.

6. Trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Hans Kijlstra, pasi u njoh me rezultatet e hetimit dhe provat e grumbulluara për kriterin e vlerësimit të pasurisë në datën 25.10.2019, vendosi: (i) të përfundojë hetimin paraprak për subjektin e rivlerësimit, z. Simon Pashuku, vetëm për kriterin e pasurisë, pasi provat kishin arritur nivelin e provueshmërisë për këtë kriter, sipas përcaktimit të nenit 4/2, të ligjit nr. 84/2016; (ii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit se i ka kaluar barra e provës mbi rezultatet e hetimit për kriterin e pasurisë, referuar nenit 52, të ligjit nr. 84/2016; (iii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit për t’u njohur me provat e administruara nga Komisioni për kriterin e pasurisë në përputhje me nenin 47, të ligjit nr. 84/2016, dhe me nenet 45 - 47 dhe 35 - 40 të Kodit të Procedurave Administrative; (iv) të njoftojë subjektin e rivlerësimit mbi të drejtat që gëzon nga ligji në lidhje me deklarimin e konfliktit të interesit, me të drejtën për të kërkuar marrjen e provave të tjera ose thirrjen e dëshmitarit dhe me afatin brenda të cilit mund t’i ushtrojë këto të drejta.

7. Për sa më sipër, në datën 25.10.2019, subjektit iu komunikua, duke i lënë afat deri në datën 7.11.2019 për paraqitjen e shpjegimeve, ushtrimin e të drejtave për mbrojtjen e tij, në kuadër të garantimit të një procesi të rregullt ligjor. Subjekti i rivlerësimit u njoh me aktet e dosjes në datën 28.10.2019.

8. Nëpërmjet *e-mail*-it të datës 5.11.2019, subjekti i rivlerësimit kërkoi shtyrje afati për paraqitjen në formën e kërkuar nga ligji të disa akteve nga SHBA, të cilat për shkak të largësisë, ishin të pamundura të dorëzoheshin brenda afatit të lënë nga Komisioni.

9. Komisioni në vlerësim të kërkesës së subjektit, i komunikoi shtyrjen e afatit për depozitimin e këtyre dokumenteve në formën e kërkuar nga ligji dhe të përkthyer deri në datën 15.11.2019.

10. Në datën 7.11.2019, subjekti dorëzoi prapësimet bashkë me provat, duke paraqitur edhe disa kërkesa procedurale për: rihapjen e hetimit mbi bazën e të tria kritereve; thirrjen e disa dëshmitarëve; si dhe paraqitjen e disa provave.

11. Në datën 12.11.2019, trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Hans Kijlstra, vendosi mbi këto kërkesa. Vendimi arsyetuar iu njoftua subjektit në datën 13.11.2019.

12. Në datën 13.11.2019 subjekti solli në cilësinë e provës edhe aktet të marra nga SHBA në formën e kërkuar ligjore dhe të përkthyer, të cilat u administruan nga Komisioni.

13. Me vendimin nr. 3, pas administrimit të provave, trupi gjykues në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Hans Kijlstra, vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore në përputhje me nenin 55, të ligjit nr. 84/2016, në datën 15.11.2019 në Pallatin e Koncerteve, Tiranë.

14. Në datën 15.11.2019, në seancën dëgjimore, subjekti i rivlerësimit paraqiti kërkesë për përjashtimin e trupit gjykues.

15. Trupi gjykues vendosi ndërprerjen e seancës dëgjimore me qëllim që një trup tjetër gjykues të shqyrtonte kërkesën e paraqitur nga subjekti i rivlerësimit, sipas parashikimeve ligjore.

16. Pas shqyrtimit të kërkesës së depozituar nga subjekti për përjashtimin e trupit gjykues që rivlerëson çështjen e tij – trupi gjykues, i ngritur për shqyrtimin e saj me vendimin e datës 17.11.2019, vendosi ta rrëzojë këtë kërkesë. Subjekti i rivlerësimit u njoftua e nga Komisioni me shkresën datës 19.11.2019, për këtë vendim të arsyetuar.

17. Trupi gjykues vendosi vijimin e seancës dëgjimore për këtë subjekt në datën 21.11. 2019.

18. Vendimi mbi përfundimin e procesit të rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, z. Simon Pashuku, vetëm mbi kriterin e vlerësimit të pasurisë, nuk përbën në asnjë rast gjë të gjykuar për kriterin e figurës dhe atë të vlerësimit profesional.

## **I. SEANCA DËGJIMORE**

19. Në datat 15.11.2019 dhe 21.11.2019 u zhvilluan dy seanca dëgjimore në prezencë të subjektit të rivlerësimit dhe në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Hans Kijlstra, në përputhje me kërkesat e nenit 55, të ligjit nr. 84/2016. Subjekti i rivlerësimit u paraqit personalisht në seancë. Në përfundim të seancës dëgjimore, subjekti i rivlerësimit kërkoj konfirmimin në detyrë.

20. Në datën 22.11.2019, ora 12:00, u shpall vendimi i trupit gjykues.

### **A. VLERËSIMI I PASURISË**

Inspektorati i Lartë i Deklarimit të Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit (LDKPKI) ka kryer kontroll të plotë të deklaratës së pasurisë së subjektit të rivlerësimit, z. Simon Pashuku, duke krahasuar: deklaratën e pasurisë “Vetting”; deklaratat e pasurisë në vite; dhe dokumentacionin justifikues bankar, jo bankar etj., të dorëzuar nga vetë subjekti me të dhënat e kërkuara me anë të korrespondencës me nr. \*\*\* prot., datë 3.7.2017, pranë institucioneve publike (për më tej shihni raportin e ILDKPKI-së).

Në përfundim të veprimeve verifikuese ILDKPKI-ja, bazuar në nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, ka konstatuar se:

- *deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin,*
- *nuk ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- *ka kryer fshehje të pasurisë;*
- *ka kryer deklarim të rremë*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave*

## **A/1 RIVLERËSIMI I PASURISË NGA KOMISIONI**

Komisioni ka hetuar në mënyrë të pavarur çdo informacion dhe konkluzion të institucioneve sipërpërmendur dhe të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me nenet 45, 49 dhe 50, të ligjit nr. 84/2016: (a) për verifikimin e vërtetësisë së deklarimeve në lidhje me gjendjen pasurore të subjektit dhe personave të lidhur; (b) për verifikimin e burimeve të krijimit të të ardhurave dhe shpenzimeve, me qëllim evidentimin e mungesës së mundshme, të burimeve të mjaftueshme financiare për të justifikuar pasuritë; (c) në evidentimin e ndonjë fshehjeje të mundshme të sendeve në pronësi ose përdorim; dhe (ç) në evidentimin e deklarimeve të rreme apo të ndonjë konflikti të interesave, të parashikuar nga pika 5, e nenit 33, e ligjit nr. 84/2016, nga ku rezulton se:

### **Në deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar “Vetting”, subjekti i rivlerësimit, z. Simon Pashuku, ka deklaruar:**

1. Apartament banimi me sip. 120 m<sup>2</sup>, ndodhur në Rr. “P. K”, përfituar me kontratë sipërmarrjeje nr. \*\*\*, datë 7.12.2006. Burimi i krijimit, sipas deklaratës për rivlerësimin kalimtar: kredi në vlerën 25.000 euro dhe dhurime nga i vëllai dhe motrat.
2. Tokë, përfituar në bazë të ligjit nr. 7501 “Për tokën” me aktin e marrjes së tokës në pronësi, me sip. 17.050 m<sup>2</sup> dhe 200 m<sup>2</sup> truall, me nr. \*\*, në bashkëpronësi me 1/8 pjesë takuese. Burimi i krijimit sipas deklaratës për rivlerësimin kalimtar: përfituar sipas ligjit nr. 7501, “Për tokën”.
3. Shtëpi banimi, me sip. 90-100 m<sup>2</sup>, në fshatin B. M, Shkodër, në bashkëpronësi me 1/8 pjesë takuese. Burimi i krijimit sipas deklaratës për rivlerësimin kalimtar: trashëguar nga babai.
4. Ndërtesë, me sip. 56 m<sup>2</sup> dhe 40 m<sup>2</sup> pistë, në fshatin B. M, Shkodër, në proces legalizimi, ndërtuar së bashku me vëllain. Burimi i krijimit sipas deklaratës për rivlerësimin kalimtar: të ardhura nga paga e subjektit të rivlerësimit dhe të ardhurat e vëllait.
5. Depozitë në vlerën 20.000 euro në “C.B”. Burimi i krijimit sipas deklaratës për rivlerësimin kalimtar: të ardhura nga qiraja e objektit.
6. Llogari bankare në vlerën 11.054 euro, në “R. B”. Burimi i krijimit sipas deklaratës për rivlerësimin kalimtar: të ardhura nga qiraja e objektit dhe gjendje *cash* në vlerën 1.200.000 lekë nga qiraja e objektit, si dhe kursimet.
7. Gjendje *cash* në vlerën 1.200.000 lekë e krijuar nga qiraja e objektit, si dhe nga kursimet familjare.
8. Llogari bankare në vlerën 90.649 lekë në “BKT”, në emër të D. P, krijuar nga kalimi muaj për muaj nga paga e bashkëshortes në këtë llogari.
9. Llogari bankare në vlerën 90.649 lekë, në “BKT” në emër të D.P, krijuar nga kalimi muaj për muaj nga paga e bashkëshortes në këtë llogari.
10. Llogari bankare në vlerën 80.021 lekë, në “BKT”, në emër të D. P, krijuar nga kalimi muaj për muaj nga paga e bashkëshortes në këtë llogari.

Subjekti, në seksionin e detyrimeve, ka deklaruar:

Kredi nga “R. B” marrë me kontratën nr. \*\*\*, datë 24.4.2008, me afat 20 vjet në vlerën 25.000 euro. Vlera e detyrimit financiar mbetur e pa shlyer: 16.458,91 euro.

Bashkëshortja e subjektit, në deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar të subjektit të rivlerësimit, ka deklaruar:

Automjet tip "Volkswagen Golf" me targa AA \*\*\* HI, në pronësi të bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit me pjesë takuese 100 %. Vlera: 300.000 lekë.

**1. Apartament me sip. 120 m<sup>2</sup>, ndodhur në Rr. "P. K" Shkodër,** përfituar në bazë të kontratës së sipërmarrjes nr. \*\*\*, datë 7.12.2006. Vlera: 60.000 euro. Burimi i krijimit: kredi në vlerën 25.000 euro dhe dhurime (vëllai dhe motrat).

### **Faktet e rezultuara nga hetimi administrativ**

Në deklaratën e interesave privatë para fillimit të detyrës, subjekti nuk deklaroi burimin e krijimit të kësaj pasurie, si dhe pjesën takuese që zotëron.

Në datën 7.12.2006, me kontratë sipërmarrjeje nr. \*\*\*, subjekti i rivlerësimit ka porositur një apartament banimi me sip.120 m<sup>2</sup>, duke paguar këstin e parë në shumën 30.000 euro. Bazuar në kontratën e sipërmarrjes, kësti i dyti në shumën 30.000 euro, do të paguhej kur të përfundonte apartamenti dhe ti dorëzohej subjektit.

Subjekti, në procesverbalin e datës 15.4.2016, mbajtur nga inspektori A. B<sup>1</sup>, deklaroi se nuk ka pasur arsye specifike për dhurimin e kësaj shumë (vëllai dhe motrat), por ka qenë thjesht dëshira e tyre për ta ndihmuar.

Me pyetësin e parë protokolluar në Komision me nr\*\*\* prot., datë 29.3.2018, subjekti deklaroi se ky apartament nuk është hipotekuar.

Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 26.4.2018, nuk e konfirmon apartamentin me sip. 120 m<sup>2</sup>, deklaruar nga subjekti të ndodhur në Rr. "P. K", Shkodër.

Në pyetësin e datës 29.3.2018 subjekti ka sqaruar se ka filluar të jetojë në këtë apartament që në shtator të vitit 2007.

Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 26.4.2018, nuk e konfirmon apartamentin me sip. 120 m<sup>2</sup>, deklaruar nga subjekti të ndodhur në Rr. "P. K", Shkodër.

Subjekti i rivlerësimit, si burim për blerjen e këtij apartamenti, ka deklaruar kredi nga "R. B", si dhe dhurime nga motrat dhe vëllai.

Me kontratën nr. \*\*\*, datë 24.4.2008, subjekti i rivlerësimit ka marrë kredi në shumën 25.000 euro, me afat 20 vjet. Bazuar në shkresën e "R. B" detyrimi i pashlyer i kredisë aktualisht është në vlerën 14.863,63 euro.

Bazuar në nxjerrjen e llogarisë në euro të "R. B" rezultoi se kredia bankare nga kjo bankë është disbursuar në datën 29.4.2008 dhe është tërhequr më 30.4.2008 nga subjekti i rivlerësimit në vlerën 24.625 euro.

Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar si burim për krijimin e këtij apartamenti edhe dhurime dhe për t'i provuar ka depozituar dokumentacionin e vitit 2016, ku motrat dhe vëllai deklarojnë se i kanë dhuruar shumën si më poshtë.

Deklaratë dore, datë 8.4.2016, e pafirmosur e znj. M. L, e cila në deklaroi se në vitin 2008 i ka dhuruar subjektit të rivlerësimit shumën 5.000 euro për të blerë një banesë.

---

<sup>1</sup> Shkresa nr.\*\*\* prot., datë 7.6.2019, të ILDKPKI-së.

Deklaratë dore, datë 8.4.2016, e pafirmosur e znj. N. P, e cila deklaron se në vitin 2008 i ka dhuruar subjektit të rivlerësimit shumën 8.000 euro për të blerë një banesë.

Deklaratë dore, datë 8.4.2016, e znj. M. B, e cila deklaron se në vitin 2008 i ka dhuruar subjektit të rivlerësimit shumën 5.000 euro për të blerë një banesë.

Deklaratë dore, datë 8.4.2016, e z. F.P, i cili deklaron se në vitin 2008 i ka dhuruar subjektit të rivlerësimit shumën 20.000 euro për të blerë një banesë.

Deklaratë dore, datë 9.4.2016, e z. J. M (vjehtëri i subjektit), i cili deklaron se në vitin 2008 i ka dhuruar bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit dhe subjektit të rivlerësimit shumën 3.000 euro për të blerë një banesë.

Referuar kontratës së sipërmarrjes nr. \*\*\*, datë 7.12.2006, kësti i parë 30.000 euro i është dhënë sipërmarrësit në ditën e nënshkrimit të kontratës<sup>2</sup>. Ka rezultuar se subjekti në datën 30.4.2008 ka tërhequr nga banka kredinë në shumën 25.000 euro, si dhe ka përfutur dhurimet (sipas deklaratave më lart) në vitin 2008.

Pra, si kredia bankare edhe dhurimet datojnë pas pagimit të këstit të parë të apartamentit.

Subjekti i rivlerësimit deklaron se në vitin 2007 ka kryer mobilimin e apartamentit në shumën 710.000 lekë, ndërsa dhomën e gjumit e ka blerë në vitin 2001 në shumën 120.000 lekë. Në pyetësorin e datës 29.3.2018 subjekti ka sqaruar se ka filluar të jetojë në këtë apartament që në shtator të vitit 2007.

Pasi iu kërkua nga Komisioni, subjekti me përgjigjet e protokolluara në Komision me nr. \*\*\* prot., datë 18.6.2019, depozitoi dokumentacion mbi të ardhurat e familjareve të noterizuara në shtetin italian dhe me vulë apostile.

Me përgjigjet e protokolluara në Komision me nr. \*\*\* prot., datë 18.06.2019, subjekti ndër të tjera deklaron se: *“Duke qenë se në kohën kur nga familjarët e mi, vëllai dhe motrat, si dhe babai i bashkëshortes sime më janë bërë këto dhurata, ne nuk kemi mbajtur asnjë dokument, pasi në atë periudhë unë nuk kam qenë subjekt i deklarimit dhe në bazë të ligjit nuk kam pasur detyrim të deklaroj dhuratat”* .

Subjekti ka vijuar duke shpjeguar se: *“Deklarimin e këtyre shumave që më janë dhuruar nga familjarët e mi unë e kam bërë më 15.4.2016 në ILDKPKI, kohë kur unë jam pyetur në lidhje me burimin e të ardhurave të shumës prej 60.000 euro që unë kam blerë banesën time në qytetin Shkodër. Unë për këtë fakt kam deklaruar burimin e të ardhurave, kredinë, si dhe dhuratat që më janë bërë nga familjarët e mi dhe në këtë rast në lidhje me dhuratat (shumën e parave) që më kanë dhënë familjarët e mi kanë përgatitur deklaratat të cilat janë shkruar me shkrim dore nga ana e tyre, të cilat janë dorëzuar dhe në këtë institucion. Gjithashtu, për të provuar që të ardhurat e tyre janë të ligjshme kam paraqitur dokumentacionin provues, poste pagat, kjo për të provuar se të ardhurat e tyre janë të ligjshme në bazë të punës së tyre dhe se kanë pasur mundësi financiare për të më dhuruar shumat e parave.*

*Fakti që vëllai im më ka dhuruar një shumë parash të konsiderueshme prej 20.000 euro është bërë me dëshirën e tij dhe në bazë të një marrëveshje (marrëveshje gojore), që kemi bërë unë dhe im vëlla që ai në momentin e ndarjes së pasurisë në fshatin B, Shkodër, ku ne kemi dhe banesën e trashëguar nga babai, unë do ia dhuroja atij, pra, nuk do të merrja pjesën time takuese”*.

---

<sup>2</sup> Parashikimin kontraktual: porositësi Simon Pashuku i jep sipërmarrësit N. K shumën 30.000 euro për të ndërtuar një apartament banimi me sip. 120 m<sup>2</sup>. Shuma e dhënë nga porositësi është kësti i parë i vlerës së apartamentit.

Në lidhje me dhurimin e bërë nga vjehri subjekti deklaroi se: “Në lidhje me shumën e parave 3.000 euro, shumë e cila më është dhuruar nga babai i bashkëshortes sime, shtetasi J. M, sqaroj që ky shtetas gjatë gjithë kohës ka jetuar në Shqipëri dhe në bazë të deklaratimit të tij ka pasur të ardhura për të dhuruar një shumë të tillë. Gjithashtu, për të provuar që ky shtetas ka pasur mundësi financiare po iu paraqes dhe një nxjerrje nga llogaria bankare, llogari pranë “BKT”- së Durrës, datë \*\*\*, llogari bankare e cila është çelur në vitin 2000”.

Komisioni, lidhur me dhurimin e shumës 3.000 euro nga i vjehri, z. J. M, administroi nxjerrjet e llogarisë bankare të dorëzuar nga subjekti për të provuar mundësinë financiare të vjehrit, nga ku rezultoi se kjo llogari është hapur në datën 1.5.2004, në llogarinë në lekë, dyemërore, në emër të I ose J. M, ku janë kryer disa veprime: depozitimi; hapje depozite; tërheqje interesi; tërheqje principali; dhe veprimi i fundit është tërheqje totale dhe mbyllje depozitë në shumën 2.569.155 lekë. Për vitin 2008, kur pretendohet të jetë kryer dhurimi, pronar të depozitës kanë qenë I dhe J. M dhe depozita dyemërore nuk provon mundësitë financiare të dhuruesit. Nga subjekti nuk është sjellë asnjë provë për të provuar burimin e krijimit të të ardhurave të dhuruesit, bazuar pikën 4, të nenin 32, të ligjit nr. 84/2016.

Dhurimet nga familjarët nuk deklarohen në deklaratimin për herë të parë nga subjekti i rivlerësimit në vitin 2012, si burim krijimi për këtë pasuri, bazuar në nenin 5/1<sup>3</sup>, pika 1, germa a, të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklaratimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, të ndryshuar.

Nuk ka asnjë dokument provues për dhënien e këtyre dhurimeve, si dhe mbetet e paprovuar mënyra se si janë kryer këto dhurime.

Nga informacioni i marrë gjatë hetimit administrativ nga “R. B” rezultoi se në llogarinë bankare nr. \*\*\*\*\*, në emër të Simon Pashuku, në datën 18.12.2007 është depozituar shuma 1.400.000 lekë, *cash*, nga znj. M. D dhe në të njëjtën datë kjo shumë është tërhequr *cash* nga subjekti i rivlerësimit.

Subjekti i rivlerësimit, nisur nga ky transaksion i sipërcituar, është pyetur për lidhjen që ka me znj. M. D dhe për qëllimin e depozitimit të shumës 1.400.000 lekë në llogarinë bankare të tij.

Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të pyetësorit, datë 9.4.2019, ka deklaruar se znj. M. D e ka pasur kolege, të cilës i ka marrë hua shumën 1.400.000 lekë për shlyerjen e një kësti të apartamentit. Gjithashtu, deklaroi se këtë hua e ka shlyer në vitin 2008 me marrjen e kredisë bankare.

Subjekti i rivlerësimit nuk e ka deklaruar këtë hua në deklaratën periodike vjetore të vitit 2007 dhe as shlyerjen e kësaj huaje në vitin 2008. Bashkëlidhur pyetësorit, subjekti solli në cilësinë e provës deklaratë noteriale nr. \*\*\*, datë 5.4.2019, të kryer nga znj. M. D, në të cilën deklarohet për dhënien e kësaj shume dhe kthimin e saj në datën 2.5.2008, në *cash*, si dhe një akt nxjerrje llogarie, datë \*\*\*\*, lëshuar nga “R. B” ku pasqyrohen lëvizjet bankare të kësaj shtetaseje për një periudhë të caktuar (nga data 18.2.2007–2.5.2008). Veprimi i fundit është në datën 2.5.2008, me përshkrimin “M. D derdh në llogari”.

---

<sup>3</sup> “Neni 5/1 Deklarimi para fillimit të punës

1. Të gjitha subjektet që mbartin detyrimin për deklaratim, sipas këtij ligji, duhet të deklarojnë para fillimit të punës:

a) të gjitha pasuritë e grumbulluara, detyrimet financiare dhe interesat e tjerë të përcaktuar në nenin 4 të këtij ligji, përfshirë burimet e krijimit të tyre”.

Komisioni, pas administrimit dhe vlerësimit të provave të sjella nga subjekti, vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar asnjëherë si burim për blerjen e apartamentit huan e marrë nga znj. M. D. Gjithashtu, veprimet e debitimit dhe kreditimit në shumën 1.400.000 lekë të kryera nga znj. M. D sipas aktit nxjerrje llogarie, nuk provojnë dhënien dhe kthimin e huas së pretenduar subjektit të rivlerësimit.

### **Analiza financiare për blerjen e apartamentit**

Në përgatitjen e kësaj analize financiare janë konsideruar dhe vlerësuar nga Komisioni të ardhurat e deklaruar nga subjekti në raport me konstatimet e bëra gjatë hetimit administrativ.

Në vitin 2006, referuar parashikimeve ligjore të kontratës së sipërmarrjes, është paguar shuma 30.000 euro. Burim financiar për pagimin e kështit të parë nuk kanë shërbyer dhurimet, pasi ato datojnë në vitin 2008.

### **Analizë financiare për pagesën e kështit të parë të apartamentit në vitin 2006**

<b>Përshkrimi</b>	<b>2006</b>
<b>PASURI</b>	<b>3.574.699</b>
Shtëpi banimi, me sip. 120 m <sup>2</sup> , me kontratë nr. ***, datë 7.12.2006, likuiduar në vitin 2006, shuma 30.000 euro	3,711,090
Shtesa/pakësime likuiditete	-136,391
<b>LIKUIDITETE TOTAL</b>	<b>85,098</b>
<b>DETYRIME</b>	<b>0</b>
<b>TË ARDHURA</b>	<b>786.605</b>
Të ardhura nga pagat subjekti	531,460
Të ardhura nga pagat bashkëshortja e subjektit	255,145
<b>SHPENZIME</b>	<b>450,598</b>
Shpenzime jetese sipas ILDKPKI-së	438,228
Shpenzime udhëtimi	12,370
<b>Rezultati financiar</b>	<b>-3.238.692</b>

Nga analiza e deklaratës “Vetting” në raport me deklaratimet ndër vite të administruara në dosjen e ILDKPKI-së dhe dokumentacionin e siguruar nga Komisioni nëpërmjet hetimit administrativ, bazuar në nenin 52, të ligjit nr. 84/2016, dhe në paragrafin 5, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, subjektit iu kalua barra e provës, me qëllim që të paraqiste shpjegime dhe prova të tjera për të provuar të kundërtën:

- i. e mosdeklarimit në deklaratën “Vetting”, si burim krijimi të apartamentit, huan në shumën 1.400.000 lekë marrë nga znj. M. D;
- ii. për të provuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të të ardhurave të dhënë hua nga znj. M. D, bazuar në pikën 4, të nenit 32, të ligjit 84/2016;
- iii. për konstatimin se këto dhurime nuk mund të kenë shërbyer si burim për pagesën e kështit të parë të apartamentit në vlerën 30.000 euro, shumë e cila sipas kontratës së sipërmarrjes nr. \*\*\*, datë 7.12.2006, i është paguar në këtë datë sipërmarrësit;



- iv. për mospërputhje në deklaram lidhur me burimin e kredisë në vlerën 25.000 euro, për arsye se në deklaratën “Vetting” ka deklaruar këtë burim për blerjen e apartamentit, ndërsa kur është pyetur nga Komisioni ka deklaruar se<sup>4</sup> ka përdorur kredinë për shlyerjen e huas të marrë shtetasja M. D;
- v. për mospërputhje, jo vetëm me burimet, por edhe me shumat që përfaqësojnë këto burime<sup>5</sup>, bazuar në deklaratën “Vetting”, deklarimeve të tij gjatë pyetësorëve, si dhe shpjegimeve në ILDKPKI;
- vi. subjekti është në pamjaftueshmëri financiare gjatë vitit 2006 për të kryer pagesën e këstit të parë të apartamentit, duke rezultuar me një bilanc negativ prej 3.238.692 lekësh.

### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në lidhje me faktet e konstatuara nga Komisioni**

Subjekti në deklaramet e tij është shprehur se: “..... në deklaramin përpara fillimit të detyrës nuk kam pasur detyrim për deklaramin e burimit të krijimit të kësaj pasurie pasi ligji i kohës nuk e parashikonte një detyrim të tillë.

Gjithashtu, kam menduar se duke thënë që burimi i krijimit të kësaj pasurie ishte kredia, nuk ishte e nevojshme që të deklaroja huat përpara kredisë, pasi në periudhën që kam marrë këto para nuk kam qenë subjekt i deklaramit të pasurive, cilësi të cilën e kam pasur nga viti 2012 e në vijim.

Për të paguar këstin e parë të kontratës së sipërmarrjes kam marrë hua nga shtetasi E. R me të cilin unë kam njohje personale dhe familjare në muajin dhjetor të vitit 2006 një shumë prej 30.000 euro, e cila ka shërbyer për pagesën e këstit të parë të kontratës.

Duke qenë se me marrëveshje verbale kishim rënë dakord që për një vit unë do ia ktheja këtë shumë, por me gjithë përpjekjet e miya nuk arrita të merrja kredinë pasi nuk kisha kolateral, atëherë për të shlyer një pjesë të kësaj huaje, i kam marrë hua shtetases M. D., një shumë prej 1.400.000 lekësh, të cilën në dhjetor të vitit 2007 ia kam shlyer z. E. R, ndërsa pjesën e mbetur të huas ia kam shlyer pas marrjes së kredisë dhe pas ndihmës që më kanë dhënë familjarët e mi.

Lidhur me ligjshmërinë e të ardhurave të shtetases M. D., ju bëj me dije se kjo shtetase këto të ardhura i ka përfutuar nga trashëgimia, pasi i ndjeri i ati i saj kishte shitur një tokë me një çmim prej 2.000.000 lekësh, dhe pas vdekjes së të atit ajo si trashëgimtare e vetme e tij e ka përfutuar këtë shumë”.

Për të provuar ligjshmërinë e burimit të të ardhurave të kësaj shtetaseje, subjekti ka bashkëlidhur kontratë shitje pasurie e paluajtshme me nr. \*\*\*, datë.5.12.2001 dhe dëshmi trashëgimie të znj. M. D me vendim nr. \*\*\* datë, 26.12.2006, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë.

Subjekti ka vijuar me shpjegimet e tij: “Për sa i përket ligjshmërisë së burimit të pasurive të shtetasit E. R., bashkëlidhur po ju dërgoj vërtetime për tatim fitimin e realizuar nga ky shtetas në vitin 2006 lëshuar nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve Shkodër, si dhe një deklaratë noteriale të këtij shtetasi që konfirmon marrjen dhe shlyerjen e kësaj huaje.

---

Në deklaratën “Vetting” subjekti ka deklaruar si burim kredi në shumën 25.000 euro dhe dhurime (pa përcaktuar shumën). Referuar deklarametave të dhuruesve, paraqitur në Komision nga subjekti, për të bazuar deklaramin e tij në deklaratën “Vetting”, si dhe sqarimeve të tij në pyetësorët e tretë, totali i shumave të dhuruara përfaqëson vlerën 41.000 euro. Pra, në total këto burime përfaqësojnë vlerën 66.000 euro (pra, më tepër se vlera e apartamentit). Nga ana tjetër, subjekti në procesverbalin e mbajtur në ILDKPKI në datën 15.4.2016 (shihni përgjigjen e pyetjes 2b) ka sqaruar se: “Burimi i pagesës 60.000 euro ka qenë një kredi në “R B” në shumën 25.000 euro... pjesa tjetër 35.000 euro është mbuluar nga dhurimet që më ka bërë vëllai dhe 3 motrat. Gjithashtu, një ndihmë prej 3000 euro ma ka dhuruar edhe babai i bashkëshortes sime ..” Pra, totali sipas këtij sqarimi arrin vlerën 63.000 euro.

*Dua të theksoj se mosdeklarimi i këtij veprimi nga ana ime në vitin 2012 kohë kur kam dorëzuar deklarimin përpara fillimit të punës , nuk është bërë në këtë formë por jam mjaftuar duke thënë se krijimi i burimit për të ardhurat me të cilat është blerë shtëpia e banimit kanë qenë kredia dhe dhurimet nga familjarët, kjo për faktin se shuma e huas marrë shtetasit E. R dhe shtetasës M. D., kanë qenë hua të shlyera dhe për pasojë kam menduar se nuk duhej deklaruar. Theksoj se në momentin e deklarimit huat ndaj shtetasve E. R dhe M.D kanë qenë të shlyera.*

*Unë deklaroj me përgjegjësi se burimi i vetëm i krijimit të pasurisë shtëpi banimi është kredia e marrë pranë R B në vlerën 25.000 euro dhe dhurimet që më janë bërë nga familjarët e mi (me të cilat janë paguar huat e marra për pagimin e kështit të parë si dhe shuma totale e kontratës). Në asnjë rast nuk kam pasur qëllim fshehjen e këtyre fakteve, por kam gjykuar se përmendja e tyre do të ishte e panevojshme, pasi kanë qenë hua të marra dhe të shlyera përpara se unë të bëhesha subjekt i ligjit për deklarimin e pasurive dhe duke qenë se kredia ishte marrë për të shlyer këto hua që ishin marrë për pagimin e kështit të parë të kontratës së sipërmarrjes, kam gjykuar se kredia është burimi real i krijimit të kësaj pasurie së bashku me dhurimet e familjarëve të mi të cilat në gjykimin tim kanë qenë të mjaftueshme për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të kësaj pasurie.*

*Sa i përket dhurimit prej 3.000 euro të bërë nga vjehri im, z. J. M, po ju sqaroj edhe njëherë se kemi provuar me dokumentacion se ai ka pasur deri në vitin 2006 llogari bankare së bashku me djalin e tij, z. I. M dhe në prill të vitit 2006 ka tërhequr nga banka shumën mbi 2.500.000 lekë, shumë për të cilën ju kemi dërguar nxjerrjen e llogarisë nga BKT në pyetësorin nr. 3, dhe këto para ai i ka pasur gjendje cash në banesë. Për këtë qëllim ju kemi dërguar edhe deklaratën noteriale të z. J. M.*

*Sa i përket shumës 3.238.692 lekë që del me bilanc negative në vitin 2006, sipas tabelës së përlllogaritur nga ana juaj, besoj se është e qartë se kjo diferencë negative zerohet me huan e marrë nga z. E. R, e cila provohet nga deklaratat noteriale e këtij shtetasi për dhënien dhe shlyerjen e huas”.*

Për të provuar në mënyrë shteruese këto pretendime në lidhje me këto konkluzione, subjekti kërkoi të pyeten në cilësinë e dëshmitarit shtetasit M. D, E. R dhe J M, duke dërguar të dhënat e tyre.

### **Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në raport me faktet dhe me ligjin e zbatueshëm**

Gjatë kryerjes së procedurave të rivlerësimit, objekti i hetimit dhe i vlerësimit të pasurisë ndaj subjekteve që i nënshtrohen këtij procesi, sipas nenit 179/b të Kushtetutës, materializohet në kontrollin e saktësisë dhe mjaftueshmërisë së deklarimeve të subjektit ( në deklaratën “Vetting” dhe deklaratat periodike), ku në çdo rast subjekti i rivlerësimit duhet të deklarojë tërësinë e pasurisë së tij dhe të shpjegojë bindshëm ligjshmërinë e burimit të krijimit të saj, si dhe ekzistencën e të ardhurave të ligjshme, sipas përkufizimit kushtetues.

Subjekti i rivlerësimit, në momentin e plotësimit të deklaratës “Vetting”, ka pasur detyrimin të plotësonte të dhënat për çdo pasuri në pronësi, të shpjegonte dhe të provonte mjaftueshëm lidhur me burimin e krijimit të saj, në përputhje me nenin 30, të ligjit nr. 84/2016.

Subjekti i rivlerësimit, për herë të parë deklaroi pas kalimit të barrës së provës nga Komisioni, se burimi i krijimit të pasurisë apartament është huaja në shumën 30.000 euro, marrë nga z. E. R në dhjetor të vitit 2006, për të paguar kështin e parë të kontratës së sipërmarrjes.

Subjekti ka deklaruar, pasi iu dërguan rezultatet e hetimit, se huaja e marrë nga znj. M.D në shumën 14.000 euro është përdorur për shlyerjen e huas marrë z. E. R, ndryshe nga sa ka

deklaruar më përpara në përgjigje të pyetësorit dërguar nga Komisioni, se huaja e marrë nga kjo shtetase është përdorur për shlyerjen e një kësti për blerjen e apartamentit të tij. Ky burim nuk është deklaruar as në deklaratën Vetting as në deklarinimin periodik.

Përveç analizës së provave të lartpërmendura, në raport me deklarinimet e mëparshme të subjektit dhe deklaratave të dorëzuara në ILDKPKI, Komisioni, bazuar në nenin 49/6/a, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, disponoi me vendim të ndërmjetëm mbi mospranimin e kërkesës për thirrjen e dëshmitarëve (M. D ,E. R dhe J. M), për të provuar sa më lart, për sa këta shtetas kanë shprehur vullnetin e tyre të shkruar në formë deklaratash noteriale të cilat janë administruar rregullisht nga Komisioni, e deklarinimet e tyre si dëshmitare janë të panevojshme. Ky vendim i arsyetuar iu njoftua rregullisht subjektit.

Trupi gjykues, në analizë të sa më sipër, arrin në përfundimin se:

- i. subjekti nuk ka deklaruar saktë burimin për pagesën e këstit të parë për blerjen e apartamentit;
- ii. subjekti dhe bashkëshortja e tij nuk mbulojnë me të ardhura nga burime të ligjshme pagesën e këstit të parë të apartamentit, duke rezultuar me një diferencë negative prej 3.238.692 lekësh;
- iii. në referencë të pikave 1 dhe 5, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, dhe të pikës 3, të nenit 61,të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit ndodhet në kushtet e deklarinimit të pamjaftueshëm lidhur me këtë pasuri.

**2. Tokë me sip.17.050 m<sup>2</sup> dhe truall 200 m<sup>2</sup>**, përfituar në bazë të ligjit nr. 7501 “Për tokën”, me aktin e marrjes së tokës në pronësi me nr. \*\*\*, në bashkëpronësi me 1/8 pjesë takuese.

Burimi i krijimit sipas deklaratës “Vetting”: ligji nr. 7501 “Për tokën”.

#### **Faktet e rezultuara nga hetimi administrativ**

Subjekti e deklaroi këtë pasuri në deklaratën e interesave privatë para fillimit të detyrës.

Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Shkodër konfirmon regjistrimin e kësaj pasurie.

Nga vlerësimi i praktikës, Komisioni konstaton se toka është përfituar me AMTP-në me nr. 123, në mbështetje të ligjit nr. 7501, datë 19.7.1991, “Për tokën”, dhënë familjes së D.K. P nga fshati B. M dhe se referuar certifikatës familjare të datës 21.10.2016 dhe dëshmisë së trashëgimisë ligjore për të ndjerin D. K. P, rezultoi përfitimi i kësaj pasurie në 1/8 pjesë të pasurisë trashëgimore.

- ✓ Deklarimi i subjektit përputhet me informacionin e administruar nga organet kompetente.

**3. Shtëpi banimi me sip. 90-100 m<sup>2</sup>, në fshatin B M, Shkodër**, trashëguar nga babai. Pjesa takuese: 1/8.

#### **Faktet e rezultuara nga hetimi administrativ**

Kjo pasuri është deklaruar në deklaratën para fillimit të detyrës.

Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Shkodër, me shkresën nr\*\*\* prot., datë 25.7.2018, konfirmon se pasuria me nr.\*\*\* z.k. \*\*\*, e llojit ar ë+ truall, me sip. 200 m<sup>2</sup>, nga ku 90 m<sup>2</sup> ndërtesë është e afishuar në emër të D. K.P sipas AMTP-së nr. \*\*\*, e pacertifikuar.

- ✓ Deklarimi i subjektit përputhet me informacionin e administruar nga organet kompetente.

**4. Ndërtesë me sip. 56 m<sup>2</sup> dhe pistë me sip. 40 m<sup>2</sup>,** në fshatin B. M Shkodër, në proces legalizimi, ndërtuar me vëllain, me të ardhura nga paga e subjektit dhe të ardhura nga vëllai me pjesë takuese ½.

Në deklaratën e interesave privatë të vitit 2012 deklarohet ndërtesë me sip. 100 m<sup>2</sup> në fshatin B. M, Shkodër, në proces legalizimi dhënë me qira pa akt noterial në shumën 60.000 lekë. Subjekti nuk deklaron vitin e krijimit, vlerën dhe pjesën takuese që zotëron, si dhe burimin e krijimit për këtë pasuri.

#### **Faktet e rezultuara nga hetimi administrativ**

ALUIZNI, me shkresën nr. \*\*\*\* prot., datë 8.6.2018, informon se z. Simon D Pashuku i datëlindjes 18.2.1974 është aplikues me praktikën nr. \*\*\*, datë 6.11.2006.

Nga praktika e ALUIZNI-t rezulton se subjekti ka plotësuar formularin e vetëdeklarimit nr\*\*\*\* prot., në datën 6.11.2006, për legalizimin e objektit dyqan të ndodhur në B M, ndërtuar në datë 7.5.2002. Sipërfaqja e zënë 200 m<sup>2</sup> dhe sipërfaqja e ndërtimit 50 m<sup>2</sup>.

Ky ndërtim sipas formularit të vetëdeklarimit është bërë nga subjekti i rivlerësimit. Ky ndërtim nuk është deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën periodike vjetore të vitit 2003 dhe as në deklaratën e vitit 2004.

ILDKPKI-ja, me shkresën nr. \*\*\*\* prot., datë 7.6.2019, vendosi në dispozicion të Komisionit procesverbalin me shpjegimet e subjektit datë 15.4.2016, mbajtur nga inspektori A. B. Në këtë procesverbal subjekti, ndër të tjera, deklaron se objektin në legalizim e ka ndërtuar me të vëllanë në fillim të vitit 2001.

Sipas procesverbalit të konstatimit të Drejtorisë Rajonale të ALUIZNI-t, Qarku Shkodër, të datës 14.1.2009, sipërfaqja e ndërtimit të objektit e deklaruar është 100 m<sup>2</sup> dhe vetëdeklarimi i objektit është me nr. \*\*\*, datë 7.9.2006.

Në procesverbalin e konstatimit të datës \*\*\*, të depozituar nga subjekti në ILDKPKI, rezulton se për vetëdeklarimin nr. \*\*\*, datë 6.11.2006, sipërfaqja e përgjithshme e ndërtimit është 56.1 m<sup>2</sup>.

Z. N. P, në deklaratën me autentifikim nënshkrimi datë 21.10.2016, ndër të tjera, deklaron se në mars të vitit 2006 për ushtrimin e aktivitetit në fushën e prodhimeve të graniteve ka marrë me qira një objekt me sip. 200 m<sup>2</sup>, me sip. ndërtimi 50 m<sup>2</sup>. Këtë aktivitet e ka ushtruar nga janari i vitit 2006 deri më 31.12.2012.

Nga analiza e deklaratës “Vetting”, në raport me deklaratimet ndër vite të administruara në dosjen e ILDKPKI-së dhe dokumentacionin e siguruar nga Komisioni nëpërmjet hetimit administrativ, bazuar në nenin 52, të ligjit nr. 84/2016, dhe në paragrafin 5, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, subjekti iu kalua barra e provës, me qëllim që të paraqiste shpjegime dhe prova të tjera për të provuar të kundërtën se:

- i. në deklaratën “Vetting” ka mosdeklarim të vlerës së investimit për këtë pasuri;
- ii. ka mospërputhje të deklaratimeve të subjektit për bashkëpronësinë mbi pasurinë/pasuritë bashkë me vëllain, për arsye se nga hetimi ka rezultuar se aplikimi dhe e gjithë korrespondenca me ALUIZNI-n është kryer nga dhe drejt subjektit;

- iii. ka mungesë të dokumentacionit provues ligjor për burimin e krijimit dhe pjesën takuese të investimit;
- iv. ka të dhëna kontradiktore në lidhje me sipërfaqen e saktë të këtij ndërtimi, investimin, si dhe vitin e ndërtimit të objektit.

### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në lidhje me faktet e konstatuara nga Komisioni**

Subjekti në deklaratimet e tij është shprehur se: *“Nga ana ime në deklaratën ‘Vetting’ nuk është deklaruar vlera e investimit në këtë objekt, gjë që nuk ka pasur asnjë qëllim fshehjeje, por ka qenë një pasaktësi në plotësimin e kësaj deklarate, pasi kam gjykuar që mjafton të deklaroj sipërfaqen. Vlera e investimit në këtë objekt ka qenë rreth 300.000 lekë të reja. Kjo gjë është deklaruar njësoj si në deklaratën përpara fillimit të detyrës në ILDKPKI edhe në deklaratën “Vetting” pa vlerë dhe asnjë nga punonjësit e ILDKPKI-së nuk më ka tërhequr vëmendjen në lidhje me këtë fakt, pra për vlerën e këtij objekti. As kur janë kërkuar sqarime në lidhje me deklaratimet e mia në ILDKPKI nuk jam pyetur asnjëherë në lidhje me vlerën e investimit në këtë objekt.*

*Sa i përket bashkëpronësisë është e vërtetë se objekti është deklaruar për legalizim vetëm nga unë, pasi vëllai në momentin e vetëdeklarimit ndodhej në Itali dhe nuk mund të firmoste formularin, por pronësia mbi truallin ku është ndërtuar objekti e bën atë bashkëpronar dhe problemi i bashkëpronësisë do të zgjidhej me avancimin e procedurave të legalizimit, sipas përcaktimeve të neneve 16, 17 të ligjit nr. 9482, datë 3.4.2006, “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar. Megjithëse ndërtesa është ndërtuar nga unë dhe vëllai dhe formulari i vetëdeklarimit është nënshkruar vetëm nga unë për arsyet që përmenda më sipër, në momentin që ky objekt do të përfundojë procedurat e legalizimit, pronësia do të jetë e përbashkët për të gjithë bashkëpronarët e truallit ku është ndërtuar ky objekt.*

*Në lidhje me të dhënat kontradiktore për sipërfaqen e ndërtimit, sipërfaqja e deklaruar nga ana ime në formular ka qenë 50 m<sup>2</sup>, ndërsa sipërfaqja e bazës së ndërtimit është 100 m ku përfshihet edhe një pistë thjesht dysheme e shtruar me beton e themel dhe kjo është arsyeja që kjo sipërfaqe duket kontradiktore, por në fakt objekti është 50 m<sup>2</sup> ndërtim me mbulesë dhe 50 m<sup>2</sup> pistë.”*

Subjekti, për të provuar lidhur me sipërfaqen e ndërtesës, solli në cilësinë e provës aktekspertimin e hartuar nga ekspertët B. B dhe L. C.

### **Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në raport me faktet dhe me ligjin e zbatueshëm**

Trupi gjykues, pasi shqyrtoi dokumentacionin e administruar në raport me shpjegimet e subjektit, në lidhje me vlerën e kostove të ndërtimit dhe burimet e ligjshme të përdorura për këtë pasuri, në analizë të provave në raport me faktet e konstatuara, arsyeton se:

- Nga subjekti ka mospërputhje deklarimesh në lidhje me sipërfaqen e kësaj pasurie, në deklaratën periodike e në atë Vetting. Subjekti nuk arriti të shpjegojë këto mospërputhje sipërfaqen e kësaj pasurie si dhe nuk arriti të provojë me dokumentacion provues pasjen e të drejtave ligjore bashkërisht me të, si dhe as nuk provoi të ketë vepruar me akt shkresor (prokurë) në emër dhe për llogari të vëllait. Pretendimet e subjektit për kontribut në bashkëpronësi me vëllain mbi këtë pasuri mbeten thjesht dhe vetëm në kuadër deklarativ.

Lidhur me vlerën e investimit, trupi gjykues çmon se subjekti nuk ka deklaruar vlerën reale të kostove të ndërtimit të kësaj pasurie, si dhe nuk provoi me dokumentacion provues (të tilla si situacion, fatura preventive, etj.) vlerën reale të ndërtimit, sikurse është parashikuar në pikën 26 të udhëzimit, datë 10.10.2016, të ILDKPKI-së: *“Për mënyrën e deklarimit të pasurive, në pronësi, posedim, përdorim, burimet e krijimit të tyre, detyrimet financiare, etj., nga subjektet e rivlerësimit dhe personat e lidhur që mbartin detyrimin për deklarim të pasurisë, në zbatim të ligjit nr. 84/2016, datë 30.8.2016”*.

Në përfundim, lidhur me këtë pasuri, bazuar në të gjitha provat dhe faktet e analizuara së bashku, deklarimet e subjektit gjatë hetimit dhe shqyrtimit të çështjes, trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar vlerën reale të ndërtimit dhe nuk ka provuar burimin e ligjshëm të tyre, sipas nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, duke bërë deklarim të pamjaftueshëm, referuar paragrafit 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.

## **5. Pasuritë financiare**

5.1 Depozitë në shumën 20.000 euro, në “C. B”.

Burimi i krijimit sipas deklaratës “Vetting”: të ardhura nga qiraja e objektit<sup>6</sup>.

5.2 Llogari bankare në shumën 11.054 euro, në “R.B”.

Burimi i krijimit sipas deklaratës “Vetting”: të ardhura nga qiraja e objektit.

5.3 Gjendje *cash* në shumën 1.200.000 lekë.

Burimi i krijimit sipas deklaratës “Vetting”: nga qiraja e objektit dhe nga kursime.

## **Faktet e rezultuara nga hetimi administrativ**

Dy llogaritë dhe gjendja *cash* janë deklaruar me burim nga të ardhurat nga qiraja. Në deklaratën “para fillimit të detyrës 2012”, subjekti ka deklaruar gjendjen *cash* në shumën 40.000 euro, pa deklaruar burimin. Në procesverbalin e datës 15.4.2016, mbajtur nga inspektori A. B, subjekti deklaroi si *burim krijimi të gjendjes cash qiranë, tepricat e dhuratave që i kanë bërë familjarët, si dhe kursimet nga pagat ndër vite të subjektit dhe të bashkëshortes. Gjithashtu, dhe nga tokat që janë në shërbim të familjes dhe janë të shfrytëzueshme për nevojat e familjes, e cila i ul kostot e shpenzimeve*.

Subjekti ka deklaruar në deklaratën “Vetting” se për periudhën mars 2006 – dhjetor 2012 ka deklaruar të ardhura me vlerë mujore 60.000 lekë, në shumë totale të të ardhurave neto në vlerën 4.920.000 lekë, nga qiraja e ndërtesës në B. M, Shkodër.

Subjekti i rivlerësimit, për të ardhurat e realizuara nga dhënia me qira e ndërtesës në B. M, me vlerë mujore 60.000 lekë, ka vënë në dispozicion, në cilësinë e provës, akte që lidhen me qiranë<sup>7</sup>:

- deklaratë (me autentifikim nënshkrimi nga noteri publik, si dhe të thjeshtë me shkrim dore) nga z. N. P për marrje me qira ambienti për prodhim dhe përpunim mermeri dhe graniti;
- vetëdeklarim për legalizimin e objektit datë 6.11.2006;
- aktet e regjistrimit të z. N. P, si person fizik në vitin 2015;
- kërkesë datë \*\*\*, drejtuar Drejtorisë Rajonale Tatimore Shkodër për pajisje me vërtetim pagese të tatimit mbi qiranë nga z. N. P;

---

<sup>7</sup> Provat bashkëlidhur përgjigjeve të pyetësorit, protokolluar në Komision në datën 9.4.2019.

- urdhërpagesë për muajin shtator të vitit 2016, datë \*\*\*\*;
- mandatpagesë datë 24.10.2016, për pagesë tatimi, lëshuar nga “R. B”.

Komisioni, pas vlerësimit të tyre, në harmoni me njëra-tjetrën, si dhe me përgjigjet<sup>8</sup> e ardhura nga Drejtoria Rajonale Tatimore Shkodër, konstaton se:

- Z. N. P është regjistruar si person fizik vetëm në datën 14.9.2015<sup>9</sup> me NIPT \*\*\*\*, me objekt “punime, tregtim mermeri dhe graniti”. Nga informacioni i marrë nga organi kompetent tatimor<sup>10</sup>, vetëm për vitin 2015, ky shtetas ka realizuar një qarkullim total në shumën 116.278 lekë, me një fitim neto prej 60.078 lekësh.

- Nuk provohet ekzistenca e marrëdhënies së qirasë dhe pagesat e qirasë që nga viti 2006 - 2012, nga z. N. P. Për më tepër, nuk provohet pretendimi i subjektit se ndërtesa i është dhënë me qira këtij shtetasi për ushtrimin e aktivitetit në kushtet kur ky shtetas nuk figuron i regjistruar në këtë periudhë si subjekt tatimor dhe për marrjen me qira të së cilës duhej të kishte deklaruar qiranë dhe kishte paguar tatimin sipas legjislacionit tatimor në fuqi.

- Nuk ka asnjë dokument financiar provues që z. N. P i ka dhënë subjektit qiranë në vlerën 60.000 lekë/muaj.

- Tatimi mbi shumën totale, të deklaruar dhe të pretenduar si të përfituar nga qiraja, i paguar në vitin 2016 është i pamjaftueshëm të legjitimojë sa më sipër.

Nga analiza e deklaratës “Vetting” në raport me deklaratimet ndër vite të administruara në dosjen e ILDKPKI-së dhe në dokumentacionin e siguruar nga Komisioni nëpërmjet hetimit administrativ, bazuar në nenin 52, të ligjit nr. 84/2016, dhe në paragrafin 5, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, subjektit iu kalua barra e provës, me qëllim që të paraqiste shpjegime dhe prova të tjera për të provuar të kundërtën sa më lart.

### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në lidhje me faktet e konstatuara nga Komisioni**

Subjekti në deklaratimet e tij është shprehur se: *“Në lidhje me këtë fakt më duhet të sqaroj edhe njëherë se objekti i është dhënë me qira shtetasi N. P viti 2006 deri në vitin 2012 dhe mungesa e kontratës së qirasë, ka qenë për shkak të mirëbesimit mes nesh, pasi shtetasi N. P është bashkëfshatar i imi. Sqaroj se në periudhën në fjalë nuk kam qenë subjekt deklarimi pasurie. Gjithashtu, kjo marrëdhënie ishte parashikuar të zgjaste rreth një vit dhe është ripërtërirë verbalisht vit pas viti pasi qiramarrësi synonte të gjente një objekt tjetër, ndodhur në këto kushte dhe kur kishte marrëdhënie mirëbesimi mes palëve kjo kontratë nuk është hartuar në formë shkresore. Kjo edhe për faktin se qiramarrësi nuk kishte bërë asnjë investim në objekt dhe kishim rënë dakord që kontrata mund të zgjidhej në çdo kohë, duke mos lënë pasoja ligjore për asnjërin nga palët.*

*Në lidhje me faktin se qiramarrësi nuk ka qenë i regjistruar në organet tatimore për periudhën në fjalë, mendoj se nuk ka qenë detyrim i imi që subjekti në fjalë të regjistrohej në organet tatimore, por detyrim i atij si subjekt dhe i organeve tatimore që të evidentonin një fakt të tillë dhe ta detyronin.”*

### **Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në raport me faktet dhe me ligjin e zbatueshëm**

Të ardhurat e pretenduara të gjeneruara nga dhënia me qira e objektit për ushtrimin e aktivitetit tregtar nga z. N. P nuk provohen me dokumentacion ligjor provues për sa kohë aktiviteti

<sup>8</sup> Shkresën nr. \*\*\* prot., datë 12.7.2017, në dosjen e ILDKPKI-së.

<sup>9</sup> Shkresa nr. \*\*\* prot., datë 12.7.2017, të Drejtorisë Rajonale Tatimore Shkodër, në dosjen e ILDKPKI-së.

<sup>10</sup> Shkresën nr. \*\*\* prot., datë 12.7.2017, të Drejtorisë Rajonale Tatimore Shkodër, në dosjen e ILDKPKI-së.

zhvilluar nga qiramarrësi nuk ka qenë i regjistruar në Qendra Kombetare e Biznesit dhe në organet tatimore në periudhën 2006 – 2012. Trupi gjykues vlerëson se nga dokumentacioni administruar gjatë hetimit administrativ vërtetohet fakti se shoqëria ka ushtruar aktivitet të ligjshëm vetëm nga viti 2015.

Trupi gjykues, në analizë të dokumentacionit të ardhur nga subjekti në cilësinë e provës, shpjegimeve të tij, si dhe dokumentacionit të përfituar nga hetimi mbi ushtrimin e aktivitetit të kompanisë, arrin në konkluzionin se:

- i. Subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë burimin e ligjshëm të likuiditeteve të tij bankare dhe para fizike (gjendje *cash*).
- ii. Në referencë të pikave 1 dhe 5, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, dhe të pikës 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit ndodhet në kushtet e deklaramit të pamjaftueshëm lidhur me këto likuiditete *cash* edhe në bankë.
- iii. Tatimi mbi shumën totale të deklaruar paguar në vitin 2016, nuk mundet të legjitimohet sa më sipër.

### **KONKLUZIONI PËRFUNDIMTAR**

Përfundimet e mësipërme u vlerësuan të mjaftueshme nga trupi gjykues për të konkluduar mbi kriterin e kontrollit të pasurisë së subjektit të rivlerësimit. Trupi gjykues, bazuar në përfundimet e arritura, vlerësoi se subjekti i rivlerësimit:

- a. ka kryer deklaramit të pasaktë dhe të pamjaftueshëm të pasurisë së tij në kuptim të pikave 1 dhe 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 33, të ligjit nr. 84/2016;
- b. nga analiza financiare nuk ka pasur mjete monetare të mjaftueshme në vlerën - 3.238.692 lekë për të paguar këstin e parë të apartamentit në vitin 2006;
- c. subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë burimin e ligjshëm të likuiditeteve bankare dhe të parave fizike (gjendje *cash*) deklaruar në deklaratën “Vetting”.

### **PËR KËTO ARSYE,**

Trupi gjykues, bazuar në nenet 179/b, A, Ç, D, Ë të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, dhe në pikën 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

### **VENDOSI**

1. Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Simon Pashuku, prokuror pranë Prokurorisë së Shkallës së Parë Lezhë.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit, nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik, 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

U shpall në Tiranë, në datën 22.11.2019.



**ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES**

**Brunilda BEKTESHI**  
**Kryesuese**

**Xhensila PINE**  
**Relatore**

**Suela ZHEGU**  
**Anetare**

*Sekretare gjyqësore*  
*Etmonda Hoxha*